



Nga: George Symonds

# MË BESONI, UNË JAM NDËRKOMBËTAR

**Mbi marrëdhëniet në mes të shoqërisë civile dhe Komunitetit  
ndërkombëtar në Kosovë**

**Lëvizja FOL**  
Rruga "Andrea Gropa" nr. 29 , 10000  
Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Mobil: +377(0) 44 131 542  
Ueb: [Lëvizjafol.org](http://Lëvizjafol.org)  
E-mail: [info@Lëvizjafol.org](mailto:info@Lëvizjafol.org)

## TABELA E PERMBAJTJES:

---

Falënderim .....	3
Qëllimi .....	3
Abstrakt .....	3
Lista e akronimeve .....	4
Hyrje .....	6
1. Të Dyshimitit e Jashtëzakonshëm: Thashethemet dhe Reputacioni .....	7
2. Dallimet në ide apo Dallimet në Interesa .....	10
2.1 Mospërballja .....	10
2.2 Pozita e UNMIK-ut .....	12
2.3 Lojërat e mëdha .....	12
2.4 Të ndihmuarit e këshilltarëve .....	13
3. Pse e tërë kjo ka rëndësi. Imperativi njerëzor .....	14
4. Tema të sugjeruara për diskutim të mëtejshëm .....	16
Përfundim .....	18
Bibliografia .....	18
Government/ Intergovernmental Resources .....	18
Media/Online Resources .....	20
Libra .....	22
Raporte te ojq-ve .....	22

---

## FALËNDERIM

---

Autori do donte të falënderojë të gjithë ata që ofruan kohën dhe gatishmërinë e tyre; në veçanti Jenny de Nijs dhe Nick Geoffreys, ku pa mikpritjen e këndshme të tyre ky shkrim do të ishte i pamundshëm.

---

## QËLLIMI

---

Ky shkrim synon të parashtroj një numër çështjesh për diskutim e që kanë lidhmëri me një seri praktikash, mënyrën se si kuptohen dhe shpjegohen ato praktika e që krzesisht kanë të bëjnë me komunitetin ndërkombëtar dhe shoqërinë civile lokale në Kosovë. Do të hulumtojë aspektin e korrupsionit të shtrirë gjithandej, keq menaxhimin, përvetësimin dhe shkelje të tjera të kryera nga individë të caktuar të personelit ndërkombëtarë dhe organizata ndërkombëtare; dhe pastaj do të shohim se si kjo trashëgimi ndikon në përpjekjet e vazhdueshme për të zhvilluar një shoqëri demokratike gjithëpërfshirëse në Kosovë. Shkrimi ka për qëllim të identifikoj në një mënyrë të kapshme, zonat me nevojë më të madhe për vëmendje publike, me qëllim që të stimuloj debate të cilat në një mënyrë apo tjetër do të sfidonin në mënyrë efektive status quo-në

---

## ABSTRAKT

---

Pavarësisht nga thashethemet të cilat janë të përhapura sa andej dhe dyshimeve për prapësitë dhe shkeljet e kryera nga komuniteti ndërkombëtar në Kosovë, dënimet aktuale janë të pakta dhe të rralla. Shkrimi advokon nevojën për një bashkëpunim më të madh në mes të shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar për të davaritur dyshimet e dyanshme. Përmes dialogut më të mirë do të ndërtohej një marrëdhënie më efektive dhe simbiotike, e cila do të fuqizonte madje edhe komunitetet me më së paku të drejta qytetare, dhe në këtë mënyrë këto veprime korruptuese dhe status quo-ja do të viheshin në llogari.

## LISTA E AKRONIMEVE

---

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
CIA	Agjencia Qendrore e Inteligjencës (Central Intelligence Agency)
RDK	Republika Demokratike e Kongos
ZPSSPKB	Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	European Union Rule of Law Mission in Kosovo (Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë)
EUPOL PROXIMA	Misioni Evropian Policor në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
TNKIJ	Tribunali Ndërkombëtar për Krime në Ish Jugosllavi
IKS	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
UNT	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimit
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forca e Kosovës
KIPRED	Institucioni Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim (Kosovo Institute for Policy Research and Development)
MNEJL	Misioni Ndërministror për Evropën Jug Lindore
NATO	Organizata Veri – Atlantike (North Atlantic Treaty Organisation)
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OIOS	Zyra e Kombeve të Bashkuara Për shërbime të Brendshme mbikëqyrëse
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë
PTK	Posta dhe Telekomuni i Kosovës
PSSPKB	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
MB	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut
KB	Kombet e Bashkuara

UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Programme)
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara

## HYRJE

---

Korrupsion, korrupsion, korrupsion. Kjo të bën të besosh se asnjë bisedë nuk zhvillohet në mes të klasave punëtoresh apo njerëzve të rëndomtë në Kosovë pa e shqiptuar këtë fjalë. Korrupsioni ka zënë vend edhe brenda vendit dhe vjen edhe nga jashtë kufijve të diskutueshëm të Kosovës. Kjo është Keyser Söze apo Chupacabra e kombit, i cili verbëron pushtetin duke penguar ndryshimet e duhura dhe ngulfatë qdo iniciative për përparim dhe fuqizim të qytetarisë lokale. Me sa shihet koncepti i korrupsionit në Kosovë ka shumë tipare të ngjashme me “terrorin” në fjalorin e Koalicionit të Vullnetshëm: ai është një një kërcënim i gjithë anshëm dhe që depërton gjithkund, i harlisur dhe i pamëshirshëm për shoqërinë, dhe një arsye i qëllimshëm për të prodhuar politika kundër produktive.

Sa ka të vërtetë këtu? Kur ka filluar problemi? Formimi i administratës së UNMIK-ut ishte një rast i pashembullt i cili vuri në pah shumë qështje të cilat kërkojnë vëmendje, ridefinimi i mandateve të organizatave ndërkombëtare dhe liria e veprimit të tyre, roli i projektuar i intervenimit të NATOS duke i dhënë karakter humanitar intervenimit, zgjerimi i personelit dhe investimet financiare për këtë personel, dhe shpresat e mëdha të njerëzve të cilët i kanë shpëtuar nga persekutimi i mëtejshëm<sup>1</sup>

Shkrimi do të merret me akuzat dhe kundër-akuzat e kryesve të dyshuar të stafit ndërkombëtar që nga viti 1999, dhe duke vënë në pah se si ato i ndikojnë përpjekjet e tanishme për të përmbushur qëllimet e tyre përkrah atyre të shoqërisë civile lokale. *Komuniteti ndërkombëtar* i referohet rangut të aktorëve të cilët jo në mënyrë direkte i kanë themelet në Kosovë, apo kanë prejardhje prej Kosovës apo Serbisë, ata zënë fill me intervenimin e NATOS në vitin 1999. Ky komunitet përfshinë departamente qeveritare të huaja të ndryshme, organizata ndër-qeveritare, OJQ dhe stafin e tyre individual të cilët bartin pasaporta të huaja. Për qëllime të caktuara të këtij shkrimi Serbia nuk është konsideruar si një aktor ndërkombëtar, duke pasur parasysh lidhjet e saj të brendshme me situatën e tanishme në Kosovë, mos marrëveshjet e vazhdueshme lidhur me njohjen e Kosovës si dhe institucionet paralele të cilat operojnë në Kosovë, pastaj Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, deklarata unilaterale e pavarësisë e vitit 2008 dhe Mendimi Këshillues i GJND-së i 4 korrikut të vitit 2010.<sup>2</sup>

Morinë e definicioneve dhe interpretimeve të konceptit të korrupsionit, ky shkrim do ta konsideroj si një përmbledhje të praktikave dhe përvojave të caktuara të keqpërdorimit të zyrave publike dhe/apo keqpërdorimit të pasurisë publike për përfitime private, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar vetëm në këto praktika si: konflikt të interesave, përvetësim, zhvatje, mashtrim, ndikim në shitje dhe nepotizëm.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> shih: I. King, E. Mason, *Paqe për çdo çmim: Si e zhgënjeu bota Kosovën* (Cornell University Press, 2006)

<sup>2</sup> Mendimi i GJND, 22 korrik 2010, Paragrafi 122 thot: ‘Gjykata ka përfunduar se deklarata e pavarësisë e 17 shkurtit 2008 nuk e ka shkelur ligjin e përgjithshëm ndërkombëtar, Rezolutën 1244 të KS (1999) apo Kornizën Kushtetuese. Si pasojë deklarata nuk e ka shkelur asnjë rregull të zbatueshme të ligjit ndërkombëtar.’

<sup>3</sup> Për diskutim më të hollësishëm shih: Analizë Politike e IKS, ‘Zgjidhja e nyjës: Ekonomia politike e korrupsionit dhe përgjegjësia në Kosovë’, 29 qershor 2010, 6-7; INTERPOL Online, ‘About Corruption’, available at: <http://ëëë.interpol.int/Public/Corruption/about.asp>

Struktura: Seksioni 1 përmend një numër rastesh mjaft të rëndësishme për të ilustruar se pse komuniteti ndërkombëtar ka fituar reputacionin që ka tani, të të qenit jo i çiltër. Seksioni 2 hulumton rezultatet e lojës së fajësisë (kush është fajtor) në mes të aktorëve lokal dhe ndërkombëtar.

Seksioni 2.2 deri 2.4 Ka të bëjë me idenë e ndikimit gjeopolitik, ndikim ky i cili mund të formësojë politikën dhe të caktoj prioritetet e ndërkombëtarëve e që nuk do të thotë se ato politika dhe prioritetet janë të përshtatshme për fuqizimin lokal. Seksioni 3 provon të përforcojë pse çështjeve humanitare duhet t'u jepet prioritet para simptomave që vijnë si rezultat i interesave të ngushta të cilat janë të përshkruara në seksionin 1 dhe 2. Seksioni 4 ofron një numër çështjesh për diskutim të mëtejshëm, debate dhe hetime. Ne vimë në përfundim se e tërë kjo do të ishte në interes të të gjitha palëve – të lokalëve dhe ndërkombëtarëve – që të punojnë së bashku në mënyrë transparente për një fuqizim më të gjerë dhe zhvillim të një shoqërie kosovare gjithëpërfshirëse.

## 1. TË DYSHIMIT E JASHTËZAKONSHËM: THASHETHEMET DHE REPUTACIONI

---

*“Korrupsioni minon çdo gjë për të cilën punojnë organet e zbatimit të ligjit. Ai i varfëron të gjitha komunitetet, dhe e kërcënon sigurinë dhe mbrojtjen e të shumtëve për përfitimin e të paktëve”*

R.K. Noble, Sekretar i përgjithshëm i INTERPOL-it

Ky seksion ofron një listë të shkurtër por jo të detajuar të rasteve të dënuara, të pezulluara, të anuluar, dhe të dyshuara të korrupsionit apo shkeljeve tjera ku përfshihen ndërkombëtarët. Qëllimi është që të ofrojmë një pasqyrë të problemeve që mund të ekzistojnë; dhe të ilustrojmë se pse ekziston një dyshim kaq i fortë se problemi si i tillë është endemic (tipik për vendin)

- 25 akuza të korrupsionit kundër stafit ndërkombëtar, me rastet është duke u marrë EULEX-i që nga 29 shtatori 2010<sup>4</sup>.
  - Gjykata e Qarkut në Prishtinë: Një ndërkombëtar, Ove Johansen, i dënuar me akuzën për korrupsion dhe dy ndërkombëtar të tjerë, Roger Raynolds dhe Ronnen Soressen, të akuzuar por mbeten si ndërkombëtarë të arratisur<sup>5</sup>
  - Gjykata e Qarkut në Pejë: dy raste në fazën e para – gjykimin. Një rast që përfshinë 18 ndërkombëtar mirëpo padia nuk është konfirmuar akoma. Të gjitha rastet janë të lidhura me zyrtarë të UNMIK-ut<sup>6</sup>.
  - Gjykata supreme: 1 zyrtar ndërkombëtar me akuza për korrupsion në fazën e provimit të pafajësisë.

<sup>4</sup> Konfirmuar në një korrespondencë në mes të autorit dhe zyrtarit të EULEX-it, shtator 2010.

<sup>5</sup> Ky rast përfshinë €300,000 të keqpërdorura në mes të PTK dhe Norëay Invest në një llogari postare në Norvegji. Për më shumë informata shih: Raporti i të drejtave të njeriut 2009 : Kosovo, U.S. Department of State; L. Marzouk & V. Musliu, ‘Të arratisurit e interpolit kundër investimeve në Kosovë’, *Balkan Insight*, 24 prill 2009; ‘Norvegjezi ekstradohet në Kosovë mu ballafaqu me akuzat’, *Balkan Insight*, 09 qershor 2009; UNMIK Media Monitoring Report, Nëntor 2006

<sup>6</sup> UNMIK nuk është në dispozicion për të të komentuar derisa gazeta shkon për mu shtypë.

- 15 shtator 2010: Ushtarët ukrainas të KFOR-it të paditur nga EULEX-i nën dyshimin për kontrabandë<sup>7</sup>.
- 22 prill 2010: Xhandarët rumun në misionin e EULEX-it të përjashtuar nga misioni dhe personeli prej 16 personash i mbajtur në paraburgim për kontrabandë është riatdhesuar për hetime në vend të vet<sup>8</sup>. Shpjegimi për këtë kontrabandim ishte “Mbase nga kohët e UNMIK-ut”<sup>9</sup>
- 2009: EULEX ka suspenduar hetimet për 11 ndërkombëtar dhe 8 punëtor lokal të hidro-sistemit të Radoniqit që kanë të bëjnë me KEK-un, për shkak të mungesës së dëshmimeve. Hetimi kishte filluar në vitin 2007<sup>10</sup>.
- Qershor 2008: Gjykimi i gjashtë ish zyrtarëve të UNMIK-ut dhe një qytetari lokal të dyshuar për keqpërdorimin e €230.000 të cilat ishin të destinuara për projekte humanitare, rasti është pezulluar për shkak të mungesës së dëshmimeve.<sup>11</sup>
- Devijim i supozuar i fondeve në vlerë €65.2 m lidhur me kontrata madhore në KEK dhe në aeroportin e Prishtinës në mes të viteve 1999 dhe 2008. UNMIK-u ka caktuar Shef Ekzekutiv të KEK-ut Jo Trutschler i cili është dënuar 3 vjet e gjysmë në Gjermani në vitin 2007, për pjesëmarrje në kontrabandimin e €3.5 milion.<sup>12</sup> Përveç indikacioneve për vjedhje të tjera, ryshfet, prishje të kontratës dhe të rregullave të tenderimit për fondet e projekteve të BE-së nën UNMIK-un, Njësia hetuese e KB-së në Kosovë anuloi hetimet në qershor të vitit 2008 për shkak të mungesës së dëshmimeve. Kjo ka ngritur shqetësime të mëdha lidhur me aftësinë monitoruese të UNMIK-ut sa i përket fatit të €989.7 milion të drejtuar nga BE për Kosovë përmes KB-së dhe Bankës Botërore<sup>13</sup>. Megjithatë, në konferencën e donatorëve me 11 korrik 2008 Komuniteti Ndërkombëtar zotoi edhe €1.2 miliard për Kosovën me kontribut €508 milion të BE-së.<sup>14</sup>
- 2006-2008: Rasti i Steven Schook. Bazuar në përvojën si Shef i Stafit për KFOR-in në mes të viteve 2003 dhe 2004, ai është caktuar si ZPSSPKB në periudhën prill 2006 – dhjetor 2007. Schook-u ishte subjekt i hetimit të OIOS për lidhje të supozuara jo profesionale me politikanët lokal duke përfshirë ministrin e atëhershëm të energjisë Ethem Qeku, personelin që lobonte për Kosovën C, dhe heqje dorë e nga dëshmia e dëshmitarëve në gjykimin e TNKIJ të Ramush Haradinajt<sup>15</sup>.

<sup>7</sup> Konferencë për shtyp e NATO, *Deklarata e zëdhënësit*, 15 shtator 2010; Konferencë për shtyp e EULEX, bastisje dhe arrestime lidhur me krimin e organizuar dhe kontrabandë, 15 shtator 2010; AlertNet, *Misioni i BE-së në Kosovë heton ish paqeruajtësit*, 15 shtator 2010; A. Palokaj, *‘Ushtarët e KFOR-it të involvuar në kontrabandimin e karburantit në Kosovë’*, *ËAZ.EUobserver.com*, 23 shtator 2010; P. Collaku, *‘BE vazhdon hetimin e kontrabandës me karburant nga KFOR-i’*, *Balkan Insight*, 20 shtator 2010

<sup>8</sup> EULEX konferencë për shtyp, Misioni i xhandarmërisë rumune përfundon, 22 prill 2010; EULEX konferencë për shtyp, deklarata e *EULEX-it për incidentin në kufi*, 21 prill 2010; Balkan Insight, *‘Kapet zyrtari i EULEX-it ‘Kontrabandimi ‘Jashtë Kosovës’*, 21 April 2010; L. Karadaku, *‘EULEX-i suspendon rumunët me akuzën për kontrabandim’*, *SETimes.com*, 27 April 2010; V. Pop, *‘Misioni i BE-së përpiket për kredibilitet pas incidentit të kontrabandës’*, *Euobserver.com*, 03 qershor 2010

<sup>9</sup> Zëdhënësi i drejtësisë i EULEX-it në bisedë me autorin, Pristina, 15 shtator 2010

<sup>10</sup> Raporti i të drejtave të njeriut 2009: *Kosovo*, U.S. Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights and Labor, ‘2009 Country Reports on Human Rights Practices’, 11 mars 2009, në dispozicion në: <http://ëëë.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2009/eur/136039.htm>, qasur për herë të fundit 29 shtator 2010

<sup>11</sup> 2009 Raporti i të drejtave të njeriut: *Kosovo*, U.S. Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights and Labor, ‘2009 Raporti i vendit për të praktikat e të drejtave të njeriut’, 11 mars 2009, mund të gjindet: <http://ëëë.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2009/eur/136039.htm>, qasur për herë të fundit 29 shtator 2010

<sup>12</sup> Ai ishte i akuzuar në Gjermani, përveç të tjerësh për mashtrim. shih: M. Zaremba, *‘Koloni Kosova: Pjesa 2. Gjendja e KB she shtatë plaqkitësit’*, *Dagens Nyheter*, 25 qershor 2007

<sup>13</sup> B. Eaterfield, *‘EU dhe UN braktisin hetimin e humbjes së £60m në Kosovë’*, *Telegraph.co.uk*, 06 May 2009; M. Zaremba, *‘Koloni Kosova: Pjesa 2. Gjendja e KB she shtatë plaqkitësit’*, *Dagens Nyheter*, 25 qershor 2007

<sup>14</sup> Europa Konferencë për shtyp, *‘Komuniteti ndërkombëtar i dhuron 1.2 billion Kosovës’*, IP/08/1134, 11 qershor 2008

<sup>15</sup> Balkan Insight, *‘Zëvendës shefi i UNMIK-ut lëshon Kosovën, 18 dhjetor 2007’*; E. Mayr, *‘Lindja e ngadalshme e një kombi’*, *Spiegel Online*, 24 prill 2008; Kompromisi i Kosovës, *‘Haradinaj, Schook dhe Ealker nën privatizimin e Kosovës’*, 26 mars 2009; GJNKIJ



Pasi që është liruar nga të gjitha akuzat nga OIOS, ai akoma shërben si këshilltar i Ramush Haradinajt në partinë AAK.

- 2007: Rasti i Alexander Borg-Oliver. Ish drejtues i zyrës ligjore të UNMIK-ut i punësuar nga UNDP, këshilltar i qeverisë së Kosovës si konsultant në Komisionin Evropian “Projekti i Ndërtimit të kapaciteteve për integritet evropian” I hetuar nga OIOS së bashku me Joachim Rucker dhe Steven Schook<sup>16</sup>, për ndikim të paligjshëm të supozuar lidhur me projektin e Kosovës C dhe tenderët e karburantit për Aeroportin e Prishtinës<sup>17</sup>. Shkathësia e shfrytëzimit të zyrës publike nga Borg-Oliver ngriti pyetje lidhur me neutralitetin e Organizatës së KB-së, dhe gjithashtu mungesë të kontrolleve të konflikteve të interesave<sup>18</sup>.
- Shkurt – Mars 2007 vrasja e dy protestuese nga njësitë policore rumune me 10 shkurt në një demonstratë të Vetëvendosje-s.<sup>19</sup> 75 policë rumun e kanë lënë misionin e tyre me 21 mars, duke mos u pajtuar me kërkesën e Zyrës Qendrore të Kombeve të Bashkuara që 11 nga këta që të mbesin deri me 14 prill për të vazhduar bashkëpunimin lidhur me hetimet. Si përgjigje UNMIK-u shprehi “keqardhje”<sup>20</sup>
- 1999 – E tashmja: Kodi thirrës i Telekomit të Monakos. Edhe pse legal, pyetje të ndryshme për fair play janë parashtruar lidhur me mënyrën e këtij tenderi. Maciej Zaremba kërkoi nga qeveria franceze që të krijoj një komision special, MNEJL<sup>21</sup> që të përdorë të gjitha kanalet diplomatike duke përfshirë KB-në, BE-në dhe Bankën Botërore për të siguruar se misioni i UNMIK-ut do t’i favorizoj kontraktuesit francez. Në pajtim me këtë, ai përpiket që PSSPKB Bernard Kouchner të ndikoj drejtorin e postës dhe komunikacionit të UNMIK-ut, Pascal Copin që të bëj presion mbi UNT që Kosova të mos ketë një kod të vetin, duke e lejuar Alcatel-in e Francës në partneritet me Telekomin e Monakos që t’i kryejnë shërbimet.<sup>22</sup> Profesi Ismet Hamiti një ish i punësuar i UNT dhe PTK-së deklaroi se kjo kontratë është “krimi më i madh ekonomik pas luftës”<sup>23</sup>
- Ish drejtori i PTK-së Agron Dida thotë se është larguar nga detyra pasi ka refuzuar të nënshkruaj kontratën me Telekomin e Monakos duke pohuar se Siemens ka bërë një ofertë më të favorshme në çdo aspekt<sup>24</sup>. Më pastaj ai pyet pse Ministri i Komunikacionit e ka vizituar Monakon para tenderit<sup>25</sup>.

<sup>16</sup> Konferencë për shtyp, *Haradinaj, Balaj, dhe Brahimaj bëjnë ankesë*, 21 qershor 2010; M. Simons, ‘Ish lideri në Kosovë akuzohet për krime lufte’, *The New York Times*, 4 prill 2008

<sup>17</sup> UNMIK Konferencë për shtyp, ‘OIOS Hetimet zgjerohen më shumë në stafin senior të UNMIK-ut (*Express*)’, 31 tetor 2007, gjendet net: [http://ëëë.unmikonline.org/dpi/localmed.nsf/0/5A8ACC7C60E202FCC125738500304F66/\\$FILE/Headlines%20-%2031.10.07.doc](http://ëëë.unmikonline.org/dpi/localmed.nsf/0/5A8ACC7C60E202FCC125738500304F66/$FILE/Headlines%20-%2031.10.07.doc)

<sup>18</sup> Deda, Ilir, Raporti i shtëpisë së lirisë, Kosovë [Serbia], 2008, gjendet në:

<http://ëëë.freedomhouse.org/template.cfm?page=47&nit=456&year=2008>

<sup>19</sup> Russell Lee, M., ‘UN’s Borg-Olivier, Earned for Pro-Kosovo Quotes, Is Paid Through UNDP to Advise Kosovo’, *Inner City Press*, 03 September 2010, gjendet në: <http://ëëë.innercitypress.com/un2borg090308.html>

<sup>20</sup> Amnesty International, ‘Kosovo (Serbia): Vetëvendosje! Aktivistët rrihen gjatë arrestimit të Kurtit’, 21 qershor 2010

<sup>21</sup> UNMIK Press Office, ‘Largimi i rumunëve FPU nga Kosova’, Konferencë për shtyp, UNMIK/PR/1654, 23 March 2007

<sup>22</sup> Misioni ndërministror për Evropën jug-lindore, original: Mission interministérielle pour l’Europe du Sud-Est

<sup>23</sup> M. Zaremba, ‘Koloni Kosova: pjesa 2. Shteti i UNMIK-ut the shtatë plaqkitësit’, *Dagens Nyheter*, 25 qershor 2007

<sup>24</sup> UNMIK Online, Media Monitoring, Economic Neës, ‘PTK-MT: Krimi më i madh ekonomik pas lufte (*Lajm*)’, 2 qershor 2006

<sup>25</sup> UNMIK Online, Media Monitoring, Local Media, ‘Asnjë operator jashtë Kosovës nuk ka njohuri për Vala 900 (*Koha*)’, 07 tetor 2002; M. Zaremba, ‘Koloni Kosova: pjesa 2. Shteti i UNMIK-ut the shtatë plaqkitësit’, *Dagens Nyheter*, 25 qershor 2007

- **Aeroporti i Prishtinës:**

- Akuzat e përhapura gjithandej për ryshfet dhe seks – për – punë, që implikojnë Briton Ioan Eoollett<sup>26</sup>. Eiki Leaks citon dokumente nga 2004 deri më 2007 që tregojnë për hetime të cilat janë anuluar për shkak të mungesës së dëshmive<sup>27</sup>.
- Tetor 2005, Konferencë për Shtyp e OIOS thuhet “30 hetime për mashtrime të mundshme, dhunim, mito dhe sjellje të keqe në aeroportin e Prishtinës si dhe një grumbull problemesh të keq menaxhimit në UNMIK.... UNMIK-u nuk merrte hapat e domosdoshëm lidhur me këto shkelje; “shkeljet teknike” në funksion të sigurisë; “OIOS nuk kishte autoritet ligjor; sipas OIOS aktualisht nuk kishte mbrojtje për ata që sollën praktika të keqpërdorimit në Kombe të Bashkuara; mungesa e pavarësisë së zyrës ; dhe probleme serioze të keq menaxhimit në Kosovë për shkak të mungesës së mekanizmave mbikëqyrës dhe llogaridhënës.”<sup>28</sup>

- 16 shkurt 2001 Incidenti në Ekspresin e Nishit: një bombë teledirigjuese vret 12 dhe plagos 40 persona në një autobus afër Podujevës. I dyshuari kryesor Florim Ejupi ia del të arratiset nga paraburgimi në Bondsteel me 14 maj, ai arrestohet sërish në Shqipëri në vitin 2005 i cili ishte ngarkuar me akuza më 13 prill të të njëjtit vit<sup>29</sup>. Ai është dënuar me 40 vite me 6 qershor 2008<sup>30</sup> dhe është liruar me një vendim të Gjykatës Supreme me 12 mars 2009 për shkak të mungesës së dëshmive<sup>31</sup>. Arratisja e madhe e Ejupit nga kompleksi ushtarak, pohimi se CIA është e involvuar<sup>32</sup> dhe paaftësia e KFOR-it për të dhënë një përgjigje për masakrën e 2004-ës – mos ndëshkimet e vazhdueshme të shumë kryerësve të krimit – etërë kjo tregon nivelin komandues të komunitetit ndërkombëtar si aspak kompetent, dhe si shumë të pa sinqertë.

## 2. DALLIMET NË IDE APO DALLIMET NË INTERESA

---

### 2.1 MOSPËRBALLJA

---

*“Ndërkombëtarët... ata ju premtojnë juve gjithçka, mirëpo në fund ju lënë me asgjë.”<sup>33</sup>*

Si bëhet që aktorët ndërkombëtar dhe lokal lidhen mes vete kur përpjekja për të analizuar dhe për t'i tejkalar frustrimet të cilat shkakun ekanë në praktikat të cilat i kemi parë në rastet e sipërpërmendura? Mbase burimi më i madh i fyerjes së lokalëve ndaj pranisë së ndërkombëtarëve buron nga “shpirti optimist i 1999-ës” me shpresa të mëdha për një të ardhme më të mirë e cila është shkatërruar dhe zëvendësuar me “trashëgiminë më të keqe” të pasigurisë dhe të heqjes së të drejtave të qytetarisë<sup>34</sup>.

<sup>26</sup> UNMIK Online, Media Monitoring, Local Media, ‘Asnjë operator jashtë Kosovës nuk ka njohuri për Vala 900 (Koha)’, 07 October 2002

<sup>27</sup> M. Zaremba, ‘Koloni Kosova: pjesa 1. Raport nga Unmikistani, Vendi I së ardhmes, *Dagens Nyheter*, 25 qershor 2007; ‘Ish drejtor I aeroportit kryesor të Kosovës nën dyshimin për mito’ Qendra për paqe në Ballkan, 03 Janar 2007, available at: <http://ëëë.balkanpeace.org/index.php?index=article&articleid=14147>

<sup>28</sup> EikiLeaks.org,

[http://ëikileaks.org/ëiki/United\\_Nations\\_Interim\\_Administration\\_Mission\\_in\\_Kosovo:\\_Allegations\\_of\\_Bribes/Kickbacks\\_for\\_Employment\\_at\\_Pristina\\_Airport\\_\(Case\\_No.\\_377-04\),\\_1\\_Jan\\_2005](http://ëikileaks.org/ëiki/United_Nations_Interim_Administration_Mission_in_Kosovo:_Allegations_of_Bribes/Kickbacks_for_Employment_at_Pristina_Airport_(Case_No._377-04),_1_Jan_2005)

<sup>29</sup> UN Department of Public Information, Press Conference By Office Of Internal Oversight Services, 18 October 2010, available at: [http://ëëë.un.org/Neës/briefings/docs/2005/051018\\_OIOS\\_PC.doc.htm](http://ëëë.un.org/Neës/briefings/docs/2005/051018_OIOS_PC.doc.htm); ReliefEëb. ‘Roja e Un-it citon abuzime seksuale, korrupcioni ne Un udhëheqë Kosovën’, 28 tetor 2005, (citing Agence France-Presse), available at: <http://ëëë.reliefëeb.int/rë/RËB.NSF/db900SID/RMOI-6HB97G?OpenDocument&rc=4&cc=scm>

<sup>30</sup> Amnesty International, Briefing to the Human Rights Committee 87<sup>th</sup> Session, July 2006, 17, available at: <http://report2009.amnesty.org/en/regions/europe-central-asia/serbia>

<sup>31</sup> U.S. Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights and Labor, *2008 Human Rights Report: Kosovo*, '2008 Country Reports on Human Rights Practices', 25 February 2009, Available at: <http://ëëë.state.gov/drl/rls/hrrpt/2008/eur/119462.htm>

Agimi i ndritshëm i lirisë u pasua me errësirën e konfliktit kombëtar-etni, me mjegullën e shpërdorimit dhe varësinë nga donatorët. Kjo mjegull akoma zgjat, dhe në mënyrë paradoksale e bën më të vështirë për t'i identifikuar burimet e saj, dhe kështu duke vazhduar ti mjegulloj shtigjet e Kosovës drejt një emancipimi të plotë politik.

Fajtorët kryesor të mos kënaqësisë së Kosovës variojnë në mënyrë të madhe edhe varësisht në atë se kush kë e dëgjon. Disa i kanë cituar popullatën e re si të pa durueshme e cila dëshiron ndryshim të shpejtë<sup>35</sup>, derisa të tjerë thonë se shqetësimet e gjeneratës së re janë legjitime<sup>6</sup>. Akuzat e relativizimit kulturor, niveli jo i duhur i arsimimit i një pjesë të caktuar të popullatës. Ndërkombëtarët mund të thonë se struktura e bazuar në *klan* e shumicës së popullsisë “shqiptare” në mënyrë të natyrshme ka shpie në sistemet patronazhe dhe e shpjegon mungesën e “shpirtit publik”<sup>37</sup> dhe mungesën e një “koncepti të së mirës publike”<sup>38</sup>. Të shohësh rrjetin familjar të dikujt të zgjeruar është vërtetë e këndshme dhe e ndershme, ndërsa të zësh zyrën publike për vet-pasurim, kjo është kontradiktore. Opozita pretendon se ky stres në kulturën lokale nuk është gjë tjetër vetëm se një justifikim i komunitetit ndërkombëtar për të maskuar dështimet e tyre. Referimet të “klanet” tradhtojnë një vështrim Orientalist<sup>39</sup> dhe në fakt e ashtu quajtura kulturë perëndimore dhe civilizim perëndimor është në mënyrë të trashëgueshme imperialiste, shtëpia shpirtërore dhe fizike e Niccolo Machiavelli, si thoshte Mahatma Ghandi-i “do të ishte ide e mirë”.

Nuk ka shumë edhe shumë mundësi veprimi për të përparuar në lojën e fajësimit. Anëtarë individual te stafit të EULEX-it të intervistuar të lënë të kuptosh se janë shumë të vetëdijshëm dhe të mirë kuptueshëm sa i përket frustrimin publik në lidhje me ritmin e ngadalshëm me të cilin po funksionon ligji. Ata kanë theksuar domosdoshmërinë e kohës që nevojitet për mledhjen e dëshmimeve për të ngritur një rast të fortë, ose në të kundërtën do të përfundojnë me mbylljen e rastit për shkak të mungesës së fakteve. Ata pohojnë se “ne nuk jemi UNMIK” dhe në mënyrë kushtetuese janë pjesë të gjykatave kombëtare, megjithëse me imunitet. Ata ankoheshin për shoqërinë civile të cilët nuk bëjnë dallim por i bëjnë bashkë të gjitha organizatat ndërkombëtare si “të gjitha të njëjta”. Nevoja për të ndërtuar marrëdhënie të besueshme me shoqërinë civile është theksuar, dhe sipas tyre mënyra më e mirë që EULEX të përforcoj sundimin e ligjit duhet të aftësohen vetë lokalët dhe të aftësohen e fuqizohen institucionet e tyre.<sup>40</sup> Logjika të bën të kuptosh se ndonjë mosbesim apo keqkuptim ndaj qëllimeve të mira të EULEX-it janë faktor i komunikimit të pamjaftueshëm dhe **PR**

<sup>32</sup> EULEX Press Release, Një vendim në rastin Ekspresi I Nishit, 13 mars 2009, available at: <http://ëëë.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0005.php>

<sup>33</sup> B. Graham, ‘Gabimi I trupave britanike shpie të autobusi bombë’ *Sunday Times*, 29 korrik 2001, cituar në Qendra për paqe në Ballkan, korrik 2001 Archives, available at: <http://ëëë.balkanpeace.org/index.php?index=article&articleid=10059>

<sup>34</sup> Organizues fushate për minoritete dhe ish kontraktor I OSBE-së në intervistë me autorin, Pristina, korrik 2010

<sup>35</sup> Ismet Hamiti, në intervistë me autorin, Pristina, 18 shtator 2010

<sup>36</sup> Staf local I një OJQ-je në Ferizaj, korrik 2010

<sup>37</sup> Zyrtar local i ICRC në intervistë me autorin, Pristina, July 2010

<sup>38</sup> Ëhit Mason, co-author of *Paqe për qdo qmim*, në bisedë me autorin, 13 shtator 2010

<sup>39</sup> Zyrtar senior rajonal i FMN-së, në bisedë me autorin, shtator 2010

<sup>40</sup> Ilir Deda of KIPRED në intervistë me autorin, Pristina, 03 shtator 2010

## 2.2 POZITA E UNMIK-UT

---

Që nga 2008-a, EULEX-i ka trashëguar 200 raste nga UNMIK-u të cilat do t'i shtohen listës së punëve të pa kryera të tyre. Duke ndjekur këshillën e stafit të EULEX-it se ku me marrë këtë informacion lidhur me këto raste, përgjigja e UNMIK-ut për zyrtarët e tij që po gjykohen nga EULEX-i ishte “UNMIK-u nuk ka funksion ligjor më, prandaj edhe nuk janë marrë statistika në këtë fushë prej EULEX-it”<sup>41</sup>. Mungesa e një koordinimi të qartë dhe transparencës parashtron pyetjen se si UNMIK-u mund të implementoj një strategji të largimit me një komunikim minimal madje edhe me partnerët kyç.

Në të vërtetë, përveç monitorimit të furnizimit me të dhëna të mediave, ëbsite-i i UNMIK-ut është i braktisur, disa numra telefoni, s'ka më punë dhe nuk ofron ndonjë kontakt për Mitrovicën. Duke e pyetur një zyrtar shtypi të EULEX-it në lidhje me marrëdhëniet e organizatës me UNMIK-un dhe akuzat ndal politikave që i japin prioritet stabilitetit para se sundimit të ligjit, morëm një përgjigje të pa sherr “Ka shumë lojëra politike. Ai nuk është një citim zyrtar!”<sup>42</sup>

## 2.3 LOJËRAT E MËDHA

---

Implikimi i komentit të mësipërm na shpie neve në një fushë tjetër të diskutimit relativisht të neglizhuar – dinamika e brendshme e Kosovës si një faktor i efikasitetit të saj gjeopolitik. Këtu, shpjegimi përjetshëm i Tukididit për luftën që bëhet për “frikë, nder, dhe interesa” vazhdon të tingëllojë i vërtetë. Në rastin e sulmeve ajrore të NATO-s në vitin 1999, koncepti i intervenimit humanitar, një arsytim të cilit i kemi pasur frikën (faji i mosveprimit), për të respektuar (të drejtat njerëzore {apo evropiane}) me qëllim të interesit në (stabilitetin rajonal). Krahasuar me rajonet tjera përreth globit duke bartur barrë e superfuqisë në përpjekjet ushtarake që nga Lufta e Dytë Botërore, justifikimet e suksesshme për dhembshurinë njerëzore bënë shumicën e kosovarëve t' ekspozohen veçanërisht SHBA-ve dhe udhëheqësve politik të Mbretërisë së Bashkuar.

Madje edhe nëse premisa e intervenimit humanitar nga NATO pranohet, mënyra e zhvillimit të politikave nga ndërkombëtarët tregon se gjërat shumë kohë më parë janë rikthyer në biznes dhe kjo është e qartë. Ashtu siq e kemi përmendur më parë rastin e Telekomit Alcatel/Monako, kjo kryesisht involvon tender agresiv për korporata të ndryshme shumëkombëshe dhe këshilltarë. Dhe për me tepër popullata e bindur<sup>43</sup> dhe përjetësisht mirënjohëse do të jetë lojë në duart e atyre të cilët mbajnë zarin e Lojës së Madhe në secilin vend ku shkelin, dhe në mënyrë të pashmangshme do t'i shkelin rëndë. Një indikator për këtë është fakti i çështjes së hapur të pothuajse qasjes dogmatike të tregut të lirë për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore e që është vetëm fillimi për të fituar forcë tërheqëse.<sup>44</sup>

---

<sup>41</sup> Zyrtar i EULEX-it nga zyra e programimit dhe divizioni i pronave në intervistë me autorin, Pristina, shtator 2010

<sup>42</sup> Zyrtar për informim publik i UNMIK-ut korrespondencë me email, 30 shtator 2010

<sup>43</sup> Shtator 2010

<sup>44</sup> shih UNDP Earl Earning Reports duke treguar pakënaqësi të madh e publike me UNMIK-un dhe institucionet tjera, available at: <http://ëëë.kosovo.undp.org/?cid=2,4>

R. Knudsen, 'Privatizimi në Kosovë: Projekti ndërkombëtar 1999 – 2008', *NUPI*, 2010

Për shkak të mungesës së informacionit në disponim mbi investimet e huaja dhe lidhjet e tyre politike, shembuj potencial për çështje të tilla mund të involvojnë në hetime tenderët dhe kontraktuesit e Albright Stonebridge Group<sup>45</sup>, suplementarët e Halliburton-it Kellogg Broën dhe Root në kampin Bondsteel dhe qirane e saj 99 vjeqare; pastaj ndërmarrjen e përbashkët Amerikane – Turke Bechtel – ENKA në vlerë prej 735 m eur<sup>46</sup> në projektin kontraversor të autostradës së Kosovës të sanksionuar nga Ministri i Transportit Limaj<sup>47</sup>. Gjëra të tilla kërkojnë transparencë më të madhe për ti adresuar qështjet se Kosova nuk është gjë tjetër pos “vend për aterrimin e avionëve” për ushtrinë e SHBA-ve për sigurinë në Ballkan.<sup>48</sup>

Është e rëndësishme të përmendim se EULEX-i nuk është misioni i parë i BE-së i llojit të vet. Projekti EUPOL PROXIMA në IRJM ishte një operacion në mes të dhjetorit 2003 deri në 2005 për të monitoruar, udhëhequr dhe këshilluar policinë e vendit në mënyrë që të ndihmojnë të luftojnë krimin e organizuar dhe gjithashtu për të promovuar standardet policore evropiane<sup>49</sup>. Një ish zyrtar i Komisionit Evropian ka folur me kusht të respektimit të anonimitetit të tij – se në vitin 2004 shtatë ushtarë të PROXIMA-s kanë qenë të involvuar në një skandal të mjerë prostitucioni.

Ushtarët janë kthyer pa ndonjë akuzë kundër tyre dhe rasti është varrosur<sup>50</sup>. Në këtë implikim mësimi i vetëm i mësuar ishte se si mi heshtë ngatërresat, derisa makina burokratike vazhdon të prodhoj institucione ndërkombëtare të papërgjegjshme.

## 2.4 TË NDIHMUARIT E KËSHILLTARËVE

---

